



**Fjala e mbajtur nga Kryetari i Prezencës
Konferenca Kombëtare e Avokatit të Popullit**

Tiranë,

Hotel Tirana International

11 dhjetor 2018

I nderuar Avokat i Popullit, të nderuar pjesëtarë të panelit, të nderuar pjesëmarrës, miq dhe kolegë,

Është nder dhe kënaqësi që jam ndër folësit e kësaj konference të përvitshme.

U përmend pak më parë këtu, se kam qenë edhe më herët në Shqipëri për një periudhë kohe. Kur erdha për herë të parë në Shqipëri në mesin e viteve 90, themelimi i një zyre të ngjashme me Avokatin e Popullit ishte një ëndërr e largët. Kontrolli i pushtetit, mekanizmat kontrollues dhe ekuilibruer të lidhura me të ishin ende në një stad foshnjor dhe të pazhvilluara. Respektimi dhe mbrojtja e institucionalizuar e të drejtave të njeriut ishte ende në fund të axhendës.

Nuk kaloi shumë kohë dhe gjërat u bënë edhe më keq. Në vitin 1997, Shteti Shqiptar përfundoi në kolaps – asokohe unë punoja në Gjermani dhe merresha me çështjet e vendit tuaj – dhe qytetarët u lanë t’ia dilnin vetë ashtu si të mundeshin. Përsëri, në qendër të vëmendjes ishin shpëtimi personal dhe mbijetesa fizike, çështje të cilat ia kalonin për nga rëndësia respektimit të të drejtave të njeriut.

Por që atëherë, Shqipëria ka bërë përparime të ndjeshme në rrafshin politik, ekonomik dhe shoqëror, edhe në fushën e të drejtave të njeriut. A u bënë zhvillimet me ritmin e duhur? Kjo është një çështje që ia vlen të debatohet me seriozitet. A është gota gjysmë plot apo gjysmë bosh? As që do të përpiqesha t’i jepja përgjigje këtyre pyetjeve në këtë veprimtari, sepse do ta tejkaloja ndjeshëm kuadrin e saj. Por nëse më lejoni që ta çoj më tej metaforën e gotës, besoj se reforma në drejtësi do ta rrisë vëllimin e lëngut brenda asaj. Prezenca e OSBE-së, ashtu siç e përmendi edhe Avokatja e Popullit, ka dhënë mbështetje të qenësishme gjatë rrugës, duke e promovuar aktivisht programin e të drejtave të njeriut në përputhje me mandatin tonë. Me krenari edhe sot, ende vazhdojmë të mbështesim vendin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kemi kënaqësinë të shohim sot se Avokati i Popullit i ofron shoqërisë shqiptare një shërbim të paçmueshëm: ju siguron respektimin e të drejtave kushtetuese, ju punoni në këtë drejtim; gjithashtu, ju e çoni përpara programin e të drejtave të njeriut në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të vendit. Kjo është një detyrë vigane dhe një përgjegjësi e madhe që rëndon mbi shpatullat tuaja.

Jemi krenarë që kemi luajtur përgjatë viteve një rol të fortë mbështetës për themelimin e Zyrës së Avokatit të Popullit duke hartuar akte nënligjore, mbajtur trajnime dhe organizuar veprimtari të tjera.

Duke qenë se ky institucion është një pikë referimi për një demokraci funksionale, mbetet ende një pjesë të rëndësishme për t'u ndjekur: njerëzit duhet të mësojnë më shumë rreth Avokatit të Popullit, ta dinë mirë se çfarë mund të bëjë kjo zyrë për ta. Mund t'i shpjegoni atyre se çfarë mund të bëni për ta, me qëllim që të gjithë shqiptarët të mund t'i ndajnë ankesat e tyre me ju nëse të drejtat e tyre nuk respektohen nga institucionet publike.

Fatkeqësisht, zëvendëskryetarja e Kuvendit u largua më herët, sepse fjalitë në vijim i drejtoheshin kryesisht asaj. Në vijim, i nxis organet e tjera përbërëse të demokracisë shqiptare që t'i kushtojnë vëmendjen dhe garantojnë mbështetjen e duhur Avokatit të Popullit, dhe veçanërisht vëmendjen e duhur. Kuvendi nuk i kushton vëmendjen e duhur shumë prej raporteve të Avokatit të Popullit në lidhje me çështje të veçanta, siç ndodhi më herët këtë vit në lidhje me raportin për shpronësimet. Avokati i Popullit mund të kontribuojë pozitivisht për një demokraci shqiptare të shëndetshme dhe me reputacion të mirë, në qoftë se këtij institucioni i jepet mundësia për ta bërë këtë.

Shpresoj që kjo konferencë do të prodhojë impulsin e duhur për ta çuar Zyrën e Avokatit të Popullit më përpara në këtë drejtim. Ju uroj një konferencë të suksesshme dhe ju falënderoj për vëmendjen!